



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
I SANKSIONEVE

Data: 11 Maj 2021

Nr: 71

VENDIM

PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 47, PARAQITUR
NË KQZ NË DATËN 10.05.2021

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 11.05.2021, me pjesëmarrjen e:

Koli BELE - Relator
Elvin LAKO - Anëtar
Elvis ÇEFA - Anëtar
Ilijan RUSMALI - Anëtar
Ledio BRAHO - Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Lediana Fratari, kandidate për deputete e listës shumë-mërore të subjektit zgjedhor Koalicioni Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim për qarkun Tiranë;

OBJEKT: Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 47, paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve datë 10.05.2021.

BAZË LIGJORE: Nenet 21, 123/1, 124, 126, 129, 130 dhe 131 të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenet 17 dhe 18 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” të Komisionit Rregullator.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,



VËREN:

Zj. Lediana Fratari, kandidate për deputete e listës shumëmemërore të subjektit zgjedhor Koalicioni Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim (PD-AN) për qarkun Tiranë ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kritereve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 47 regi., datë 10.05.2021.

Në mbledhjen e datës 11.05.2021, ora 13:00, pas relativitetit të z. Koli Bele u konstatua se kërkesa ankimore nr. 47 nuk i plotësonte elementet e përcaktuara në nenin 130 shkronja “b” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, pasi kandidatët për deputetë nuk legjitimohen për të paraqitur ankim në KAS kundër vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore.

Vlen të theksohet se kundër të njëjtit vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ka paraqitur kërkesë ankimore edhe subjekti zgjedhor koalicioni PD-AN, por pa mbështetur pretendimet e ankueses në këtë kërkesë ankimore edhe pse ajo është një nga kandidatet e listës shumëmemërore të këtij subjekti zgjedhor për Qarkun e Tiranës.

Kodi Zgjedhor, në kreun X të tij rregullon ankimin në rrugë administrative të vendimeve të komisioneve zgjedhore. E drejta e ankimit parashikohet në nenet 124, 124/1 dhe 126 të këtij kodi, por duke qenë se kemi të bëjmë me një kërkesë ankimore ndaj një vendimi të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të nxjerrë në zbatim të nenit 123¹ të K.Zgjedhor, në bazë të parimit *lex specialis derogat legi generali*, do i referohemi nenit 126 të K.Zgjedhor që trajton posaçërisht formën dhe përmbajtjen e ankimit kundër vendimeve të KZAZ-së dhe vendimit të KQZ-së për shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve. Më konkretisht në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni parashikohet se “1. Ankimi zgjedhor kundër vendimeve të KZAZ-së ose vendimit të KQZ-së, sipas nenit 123 të këtij Kodi, paraqitet në formën e kërkesës ankimore dhe duhet të përmbajë elementet e mëposhtme: ... a) emrin e plotë të **subjektit zgjedhor ankues** dhe adresën e tij”. Ndërkohë, përkufizimin e “subjektit zgjedhor” na e jep pika 20 e nenit 2 të K.Zgjedhor e cila parashikon se ““Subjekte zgjedhore” janë partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si dhe kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore, të regjistruar në përputhje me këtë Kod”. Duke qenë se Tabela Përmbledhëse e Rezultatit të Zonës Zgjedhore objekt i kësaj kërkesë ankimore është për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë si dhe duke qenë se ankuesja Lediana Fratari

¹ “KQZ-ja verifikon dhe nxjerr rezultatet e votimit për zonën zgjedhore për Kuvendin apo për njësinë e qeverisjes vendore, territori i së cilës është i ndarë në dy apo më shumë ZAZ, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse. Për këtë, KQZ-ja plotëson Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore dhe e miraton atë me vendim jo më vonë se 48 orë nga mbërritja e të gjitha tabelave të zonës zgjedhore”



nuk është parti politike, koalicion apo kandidate e propozuar nga zgjedhësit, atëherë ajo nuk mund të konsiderohet subjekt zgjedhor e për rrjedhojë nuk legjitimohet për të ankimuar vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve të dalë në zbatim të nenit 123 të K.Zgjedhor.

Është pikërisht kjo linjë arsyetimi që mbështetet edhe nga Opinioni i Përbashkët “Mbi ndryshimet në Kushtetutë më 30 korrik 2020 dhe në Kodin Zgjedhor më 5 tetor 2020” i Komisionit të Venecias dhe OSCE/ODIHR i datës 11 dhjetor 2020 të cilët duke argumentuar K.Zgjedhor në fuqi, rekomandojnë që pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2021 “*të prezantohet mundësia që kandidatët individualë të apelojnë kundër ndarjes së vendeve brenda një liste*” pasi “*përfshirja e votimit preferencial, që në kushte të caktuara bën që vendet të mos ndahen sipas renditjes në listë, mund të shkaktojë mosmarrëveshje sa i përket ndarjes së vendeve brenda listës së kandidatëve. Prandaj, Komisioni i Venecias dhe ODIHR-i rekomandojnë që të prezantohet mundësia që kandidatët individualë të bëjnë ankesë dhe të apelojnë kundër ndarjes së vendeve brenda listës*”.

Në këto kushte, çdo interpretim i zgjeruar i K.Zgjedhor në fuqi në lidhje me të drejtën e ankimit për Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore, është i pambështetur në ligj dhe nuk pasqyron vullnetin e ligjvënësit.

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “b”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, të Komisionit Rregullator, kërkesa ankimore nuk duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR SA MË SIPËR:

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 126 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 17, pika 3, shkronja “b” e 18, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” të Komisionit Rregullator,



VENDOSI:

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 47, datë 10.05.2021, të paraqitur nga zj. Lediana Fratari, kandidatë për deputetë e listës shumemërore të subjektit zgjedhor Koalicioni PD-AN për qarkun Tiranë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Koli	BELE	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar



MENDIM PARALEL

1. Unë, anëtar i Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, parashtoj mendimin tim paralel ndaj arsyetimit të vendimit nr. 71, datë 11.05.2021 të KAS-it “Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 47, paraqitur në KQZ në datën 10.05.2021”.
Parashtrimi i arsyetimit të mendimit paralel lidhet me qëndrimin ndryshe në raport me arsyetimin e përdorur nga shumica e anëtarëve të KAS-it, dhe që nuk ndikon në vendimin për pranimin e kërkesës ankimore të depozituar nga zj. Lediana Fratari.
2. Referuar pikës 2 të nenit 124/1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, përcaktohet se *“kundër akteve të Komisionerit lejohet ankim në rrugë administrative në KAS nga palët që demonstrojnë një interes të ligjshëm për çështjen objekt i ankimit.”* Në gjykimin tim, zj. Fratari konsiderohet palë e tretë në kuptim të dispozitës së sipërcituar, e për këtë shkak KAS duhej të pranonte ankimin e saj.
3. Por, duke qenë se se e njëjta dispozitë, përcakton se *“në periudhën nga dalja e dekretit të Presidentit të Republikës për zhvillimin e zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar, ankimi paraqitet brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit”*, unë mbaj të njëjtin qëndrim për mospranimin për shqyrtim të kësaj kërkesë, për shkak të tejkalimit të afatit 3-ditor që përcakton Kodi Zgjedhor.

Ilirjan RUSMALI - Anëtar

